



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.599/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi-kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Sallën e Sporteve “1 Tetori”, në Komuna Prishtinë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.02.2025, merr këtë :

#### **V E N D I M**

**PRANOHET E BAZUAR** ankesa Anr.599/2025 datë 20.02.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Sallën e Sporteve “1 Tetori” në Komuna Prishtinë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09.02.2025, ashtu që **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), respektivisht Qendra Komunale e Numërimit në Prishtinë, që fletëvotimin në vendvotimin - kutia e votimit nr.1904/08, të vlerësohet si i vlefshëm dhe i njëjti të rinumërohet dhe të përfshihet në rezultatin zgjedhor.

#### **A r s y e t i m**

Me datë 20.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se me datën 19.02.2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje LVV, në Prishtinë, gjatë numërimit të votave në Sallën e Sporteve “1 Tetori” në Prishtinë ka vërejtur se fletëvotimi nga Vendvotimi me numër 1904/08, është shpallur i pavlefshëm nga komisionerët përkatës, ndonëse Fletëvotimi ka qenë në përputhje me nenin 16 të Rregullores Zgjedhore nr.12/2024 votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i vendvotimit. Sipas parashtruesit të ankesës e gjithë kjo për faktin se në fletëvotim është vendosur shenja TIK për subjektin LVV dhe jashtë katrorit vërehet një vijë e lehtë e cila nuk është vendosur në asnjërën katror të ndonjë subjekti tjetër politik. Andaj, ka kërkuar që fletëvotimi përkatës të shpallet i vlefshëm.

Si provë ka bashkangjitur Fletëvotimin.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja theksohet se bazuar në nenin 3, paragrafi 1.38 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Qendra Komunale e Numërimit (QKN) është institucioni përgjegjës për numërimin e fletëvotimeve në mënyrë transparente, në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar. Po ashtu, sipas nenit 5, paragrafi 1.4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 Qendra Komunale e Numërimit, ndër funksionet e QKN përfshihet edhe numërimi i fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve të subjekteve politike. Më tutje në përgjigje në ankesë ka theksuar se në lidhje me vlefshmërinë e fletëvotimeve, neni 16, paragrafi 2 i Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, përcakton se një votë është e vlefshme kur është shënuar vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë vullneti i votuesit. Në të kundërtën, vota konsiderohet e pavlefshme nëse:

1. Janë shënuar më shumë se një subjekt politik;
2. Nuk është shënuar asnjë subjekt politik;
3. Janë shënuar vetëm kandidatët, por jo subjekti politik;
4. Qëllimi i votuesit nuk është i qartë.

Për më tepër, sipas nenit 16, paragrafi 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024, nëse anëtarët e KVV nuk arrijnë të pajtohen lidhur me atë se a është vota e vlefshme apo i pavlefshme, atëherë kryesuesi merr vendimin përfundimtar përkitazi me atë votë dhe këtë rast e evidenton në librin e votimit. Për të pasur një pasqyrë më të qartë, lidhur me rastin konkret, KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Prishtinës, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim, duke dërguar;

1. *Librin e votimit dhe ecurinë për mbarëvajtjen procesit të numërimit në QKN, edhe për rastin konkret.*
2. *Fletëvotimin që është objekt ankese në rastin konkret*
3. *Formularin e Rezultateve për VV e caktuar.*

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunave përkatëse, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë ka gjetur se:  
**-Ankesa është e bazuar.**

Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik LVV me të cilën pretendon se për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Sallën e Sporteve "1 Tetori" në Komuna Prishtinë, gjatë numërimit fletëvotimi është shpallur i pavlefshëm nga komisioneret përkatës, për faktin se në fletëvotimin në fjalë është vendosur shenja Tik për subjektin politik LVV, e cila vërtetohet edhe nga fletëvotimi i dorëzuar si provë, dhe se jashtë katorrit vërehet një vijë e lehtë e cila nuk është vendosur në asnjë katorr (shenje) të ndonjë subjekti tjetër politik, paneli e vlerësoi se këto pretendime janë të qëndrueshme.

Bazuar në të lartëpërmendurat, paneli duke u bazuar në nenin 16 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhim i Vendvotimit, vlerëson se votat konsiderohen të vlefshme në rastet si në vijim: “16.2. Vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit: 2.1. në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e vlefshme nëse votuesi ka votuar për një (1) subjekt politik”, Kurse nënparagrafi 2.2.2, i nenit 16 përcakton se “në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e pavlefshme, në rastet kur: 2.2.1. Kur votohet më shumë se një subjekt politik; 2.2.2. kur nuk votohet asnjë subjekt politik; 2.2.3. kur votohen vetëm kandidatët dhe jo subjekti politik; 2.2.4. kur qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim.” Prandaj në rastin konkret sipas vlerësimit të panelit fletëvotimi i cili është shpallur i pavlefshëm në vendvotimin - kutia e votimit nr.1904/08, nuk hynë në kategorinë e fletëvotimeve të pavlefshme siç është e rregulluar me nenin 16 paragrafi 2.2.2 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhim i Vendvotimit, për faktin se tiku - shenja është bërë brenda katrorit ku figuron numri, përkatësisht emërtimit i subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, dhe se shenja e evidentuar në fletëvotim është jashtë katrorit, numrit dhe emërtimit të subjekteve politike të evidentuara në fletëvotimin në vendvotimin - kutia e votimit nr.1904/08, e rrjedhimisht nga kjo edhe qëllimi i votuesit është i kjashtë, dhe se sipas vlerësimit të panelit, shenja e evidentuarssss në fletëvotim jashtë katrorit, numrit dhe emërtimit të subjekteve politike të evidentuara në fletëvotimin në vendvotimin - kutia e votimit nr.1904/08, nuk e bënë këtë fletëvotim të pavlefshëm.

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 4, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me nenin 13 paragrafi 10 nën paragrafi 10.1 të Rregullores së PZAP-së Nr.01/2024, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.599/2025 datë 21.02.2025



**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.